



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS PËR SHKOLLËN E MESME TË GJUHËVE
TË HUAJA (GJIMNAZ GJUHËSOR)**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJERMANISHT

KODI: 3.3.11.B

**PROGRAMI I LËNDËS
GJERMANISHT
PËR KLASËN E 12-TË**

Koordinatorë: Erifili Hashorva

Redaktore letrare: Vjola Grillo

Përgjegjëse sektori: Marita Hamza

TIRANË, NËNTOR 2010

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të të shkollës së mesme të gjuhëve të huaja, ka për qëllim të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, të mësimnxënies dhe të vlerësimit të nxënësit në nivelin gjuhësor **B1+**, sipas Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët (në vijim KPER).

Mbështetur në filozofinë dhe në udhëzimet e Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët dhe në Kurrikulën Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar, programi i klasës së 12-të ravijëzon të gjitha njohuritë gjuhësore, ndërlëndore dhe ndërkulturore të përftuara nga klasa e 11-të, duke nxjerrë në pah baraspeshën e njohjes së gjuhës gjermane me nevojën e nxënësit për të thelluar dijet dhe, njëkohësisht, për të rritur aftësitë e tij shprehëse në gjuhën gjermane, drejt formimit të tij si përdorues i pavarur.

Programi i klasës së 12-të konsiderohet si rimarrje e njohurive, shkathtësive dhe shprehive të përftuara në klasat e mëparshme, si vazhdimësi dhe thellim i mëtejshëm i tyre në mësimin e gjuhës së huaj. Programi i klasës së 12-të konstaton dhe ka si objektivi kryesor përfitimin e aftësisë së komunikimit në një nivel shumë më të lartë nga nxënësit e kësaj grupmoshe.

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të është hartuar duke pasur parasysh interesat e nxënësve të grupmoshës 18 vjeç, të shprehura këto në tematikat e sferave të ndryshme. Ai përshkohet nga objektivi kryesor: Komunikimi në gjuhë të huaj në situata të ndryshme.

Mësimi i gjermanishtes në këtë nivel duhet të kontribuojë në aftësimin e nxënësve për ndryshimin madhor të jetës në një shoqëri demokratike.

Në këtë program theksohet se për integrimin e procesit arsimor shqiptar në strukturat ndërkombëtare dhe për rritjen e shanseve të nxënësve për punësim bazuar mbi aftësitë e tyre të zotërimit të gjuhëve të huaja, duhet të krahasohen nivelet gjuhësore të arritura në gjermanisht me ato ndërkombëtare.

Në kontekstin e sotëm social e politik, ku Shqipëria aspiron të futet në Europë dhe tendenca kryesore është krijimi i një mjedisi shumëgjuhësh e shumëkulturor, gjuha e huaj ka një mision të veçantë. Ajo do të ndihmojë në shkëmbimet kulturore midis vendeve, në zhvendosjet e udhëtimet për motive të ndryshme.

1. SYNIMI I LËNDËS

Në këtë fazë të lartë të formimit, qëllimi i gjuhës së huaj është të përpunojë kompetencat e fituara tashmë dhe t'i pasurojë ato në mënyrë që nxënës/i,-ja të arrijë dhe të konsolidojë nivelin B1+, duke e aftësuar gjithnjë e më shumë si një përdorues i pavarur i gjuhës dhe si një qytetar i Europës.

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të synon që nxënës/i,-ja:

- Të ndërjegjësohet për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendeve gjermanishtfolëse dhe kulturës amtare;
- të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme;

- të forcojë ndërveprimin në situata reale lidhur me tematikën e trajtuar si në situatat mësimore, ashtu edhe në ato jashtëshkollore;
- të konsolidojë bashkëveprimin përmes punës në grup dhe shprehive të një pune të pavarur individuale dhe krijuese;
- të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave ai zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të ka si objektiv të përgjithshëm të zhvillojë aftësinë analitike të një informacioni më të gjerë gjuhësor dhe kulturor, duke e ndërthurur këtë informacion me njohuritë e lëndëve të tjera.

Boshti kryesor i këtij programi, ashtu si dhe i kurrikulës kombëtare, përshkohet nga synimi:

- Formimi i nxënësve me mentalitetin bashkëkohor të qytetarit europian;
- përmirësimi i procesit mësimor;
- sigurimi i vijueshmërisë dhe thellimi i mëtejshëm i njohurive, shkathtësive dhe shprehive gjuhësore të nxënësve të këtij niveli.

Ky program do të pasqyrojë njohuritë e gjuhës gjermane me njohuritë e lëndëve të tjera, duke zhvilluar te nxënësi:

- Shkathtësinë me shkrim dhe me gojë;
- saktësinë me shkrim;
- aftësinë për të lidhur situatat gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale;
- aftësinë për të bërë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme;
- bashkëveprimin përmes punës në grup dhe shprehive të një pune të pavarur individuale dhe krijuese.

3. OBJEKTIVAT SIPAS STANDARDEVE

Objektivat e programit të klasës e 12-të zërthehen hollësisht sipas njësive mësimore dhe aftësive gjuhësore si më poshtë:

a) Objektivat sipas standardit në komunikim

Standardi në këtë fushë pasqyron dijet e përgjithshme të nxënës/it,-es dhe e përgatit atë emocionalisht për një përballje reale me gjuhën dhe kulturën.

Standardi	Objektiva
Komunikimi	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë pikat themelore kur përdoret një gjuhë e qartë dhe standarde dhe nëse bëhet fjalë për tema të njohura, që kanë

	<p>lidhje me punën, shkollën, kohën e lirë etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë thelbin e një numri emisionesh në radio ose në televizion mbi aktualitetin ose tema që i interesojnë personalisht drejtpërdrejt; • të bëjë një përshkrim të drejtpërdrejt dhe jo të ndërlikuar të temave të larmishme të njohura; • të përshkruajë një ëndërr, një shpresë, një ambicie; • të prezantojë veten dhe të tjerët sipas situatave të ndryshme, në mënyrë të nuancuar (formale, zyrtare, miqësore etj.); • të kuptojë njoftime të thjeshta me natyrë ekonomike.
Veprimtaritë e komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> • Të japë informacion; • të komentojë një fakt (të krahasojë, të argumentojë etj.); • të hartojë një hipotezë; • të konfirmojë; • të shkruajë një letër zyrtare (një CV, letërkërkesë, letër motivimi etj.); • të shprehë opinione pozitive/negative mbi diçka, mbi dikë; • të argumentojë, duke dhënë këshilla; • të zhvillojë një bisedë; • të shprehë pëlqime, shije etj.; • të bëjë pyetje komplekse mbi tema të shumëllojshme që shprehin interesa të ndryshme personale, publike etj. dhe të japë përgjigje komplekse për to.

b) Objektiva sipas standardit në kulturë

Standardi	Objektiva
Kulturë	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përdorë format e mirësjelljes, kur përshëndetet me dikë; • të kuptojë thelbin e njoftimeve dhe publicitetin e shkurtër;

	<ul style="list-style-type: none"> • të hartojë në gjermanisht një ftesë, si dhe udhëzime të thjeshta; • të dijë të japë të dhëna për vendndodhjen apo drejtimin për diku; • të dijë të përshkruajë motin; • të japë këshilla të thjeshta; • të përdorë, sipas regjistrave të ndryshëm të gjuhës (zyrtare, miqësore, konfidenciale, normale, informale etj.), rregullat e mirësjelljes të popullit, gjuhën e të cilit mëson, (përdorim i nuancuar i urimeve, i përshëndetjeve, i fjalëve të urta etj.); • të kërkojë fjalën në publik, duke përdorur si duhet gjestet, pozicionin që shoqërojnë ligjërimin; • të njohë monumente të artit, personalitete, ngjarje të rëndësishme të historisë dhe të aktualitetit.
--	---

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Objektivat e standardit në këtë fushë aftësojnë nxënës/in,-en të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin nivelit B1+.

Të gjithë nxënës/it,-et arrijnë një formim gjuhësor që lejon jo vetëm një komunikim të lirshëm, njohjen e strukturave gjuhësore të nevojshme, por dhe një përdorim sa më aktiv dhe pragmatik të gjuhës.

Në këtë nivel bëhet rimarrja dhe përpunimi i njohurive gramatikore të përfuara, si dhe integrohen struktura të reja gjuhësore më të ndërlikuara, që lejojnë një komunikim më të nuancuar.

Nxënës/it,-et në këtë nivel njohin mirë sistemin gramatikor, morfologjiko-sintaksor, që u lejon të shprehen lirshëm, pa ose me pak gabime, me lidhje logjike dhe me një rrjedhshmëri të mirë.

Standardi	Objektiva
Elemente gramatikore	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet në përdorimin e:</p> <p><i>Elementeve morfologjike të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nyjave dhe parafjalëve të ndryshme; • kohëve të përbëra (përshtatja në fjali të përbëra); • mbiemrave dhe përemrave dëftorë, pronorë, të pakufishëm, përemrave lidhorë; • mënyrës lidhore dhe kushtore (rimarrje);

	<ul style="list-style-type: none"> • ligjëratës së zhdrejtë (<i>Konjunktiv I</i>); • formave pasive (rimarrje dhe <i>Passiv Perfekt, Plusquamperfekt</i>); • ndërtimeve modale me foljet gjysmëndihmëse; • normave <i>participiale: Partizip I dhe II</i>. <p><i>Elementeve sintaksore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Lidhëzat (<i>konektorët</i>) logjikë. • Fjalitë e nënrenditura (kuptimet). • Elemente të koherencës dhe të kohezionit. • Fjali të nënrenditura (kohore, qëllimore, lejore...) ndërtimi i tyre. <ul style="list-style-type: none"> • Fjalitë modale (<i>wie, als, als ob, (als wäre) ohne das (ohne zu..Dativergänzung)</i>).
--	--

4: OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë pikat kryesore të një ndërhyrjeje mbi tema të njohura të hasura rregullisht në punë, në shkollë, gjatë kohës së lirë, duke përfshirë edhe tregimet e shkurtra; • të ndjekë pa vështirësi një ligjëratë, që i drejtohet atij/asaj në një bisedë të përditshme; • të identifikojë qëndrimet e folësve në diskutime për tema të njohura lidhur me shkollën, familjen dhe kohën e lirë, kur gjuha është e qartë dhe standarde; • të ndjekë pikat kryesore të një diskutimi relativisht të gjatë, me kusht që shqiptimi të jetë i qartë; • të kuptojë, me pak vështirësi, thelbin e programeve televizive dhe disa të dhëna faktike për tema të njohura; • të ndjekë, herë-herë në hollësi, udhëzimet për përdorimin e një pajisjeje elektronike vetjake, si celular, <i>flash</i> etj.; • të shpjegojë në përgjithësi informacionin që përmbajnë shumica e materialeve të regjistruara (CD, kasete audio ose video), tema e të cilave është e interesit personal dhe gjuha e qartë e standarde; • të ndjekë rrjedhën e një filmi, në të cilin subjekti mbështetet te veprimet dhe figurat.
	Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i, -ja aftësohet:

<p>Të lexuarit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë tekste faktike të drejtpërdrejta mbi tema të fushës dhe interesave të tij/saj me një nivel të kënaqshëm kuptimi; • të kuptojë, në mënyrë të mjaftueshme, përshkrimin e ngjarjeve, të ndjenjave dhe të dëshirave për të mbajtur një korrespondencë të rregullt me një mik korrespondent; • të përshkojë një tekst mjaft të gjatë për të gjetur informacionin e nevojshëm për të përmbushur një detyrë specifike; • të dallojë përfundimet kryesore të një teksti argumentues të hartuar qartë; • të kuptojë mënyrën e përdorimit të një aparati, nëse është i drejtpërdrejtë, jo i ndërlikuar dhe i hartuar qartë.
<p>Të folurit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të komunikojë me njëfarë sigurie mbi tema të njohura të zakonshme ose që nuk janë të lidhura me interesat e tij/saj; • të shkëmbejë, duke verifikuar dhe duke konfirmuar, informacione; • të përballojë situata jo aq të zakonshme, duke shpjeguar vështirësitë; • të ndjekë një ligjëratë të shqiptuar qartë që i drejtohet atij/asaj në bisedë të përditshme, por herë pas here duke kërkuar përsëritjen e disa fjalëve apo shprehjeve; • të përballojë, pa përgatitje, një bisedë mbi një temë të njohur; • të shprehë mendimin e tij/saj mbi një temë abstrakte ose kulturore, si film ose muzikë; • të komentojë shkurt pikëpamjen e dikujt; • të krahasojë ose të vërë përballë alternativave, duke diskutuar se ç’duhet bërë, ku duhet shkuar, cili duhet të zgjidhet; • të marrë pjesë në një diskutim zyrtar të përditshëm mbi një temë të njohur, që zhvillohet në një gjuhë standarde të shqiptuar qartë dhe që supozon shkëmbimin e informacioneve faktike, duke marrë udhëzime ose diskutimin e zgjidhjeve të problemeve praktike; • të përballojë shumicën e situatave, në të cilat mund të ndodhet gjatë një udhëtimi ose duke përgatitur një

	<p>udhëtim apo strehimin, ose duke diskutuar me autoritetet jashtë vendit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të japë informacionin konkret të kërkuar në një intervistë ose në një konsultim, me saktësi të kufizuar; • të komunikojë saktë me një kontroll të mirë gramatikor për tema të njohura; • të reagojë duke argumentuar lidhur me një problem që lidhet me aktivitetin e tij/saj të përditshëm.
<p>Të shkruarit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë një letër personale për të dhënë të rejat, duke shprehur mendimin mbi një temë abstrakte ose kulturore, si film ose muzikë; • të lërë shënime që transmetojnë një informacion të thjeshtë dhe të përshtatshëm në mënyrë të menjëhershme për miqtë dhe persona të tjerë që takon në jetën e përditshme, duke komunikuar në mënyrë të kuptueshme pikat që i duken më të rëndësishme; • të shkruajë letra me përshtypje mbi përvoja personale (pushime, udhëtime etj.); • të shkruajë, me rrjedhë logjike, tekste të ndryshme disi të gjata mbi tema të njohura dhe me interes për të; • të bëjë shkrime krijuese, përshkruese (<i>ese</i>) ose thjesht raportuese (raport, relacion i thjeshtë); • të shkruajë fundin e një tregimi të hapur, ose konkluzionet e një teksti me temë të njohur.

5. KËRKESA TË GJUHËS GJERMANE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Një dimension shumë i rëndësishëm i gjuhës është ai social dhe kulturor, ndaj për realizimin e këtij programi duhet mbajtur parasysh se mësimi i gjuhës shoqërohet me përvetësimin e elementeve të artit, të kulturës, të civilizimit etj. Nga ana tjetër, nga pikëpamja e teorive konjitive, nxënësi është bartës i një kulture dhe i një vëllimi dijeshe të caktuara dhe, si i tillë, tek ai ka një raport të ndërsjellë, ku gjuha e huaj shërben si mjet për të zgjeruar njohuritë, por edhe mësohet më lehtë e pasurohet nga dijet që vijnë nga fusha të tjera. Kjo e ndërgjegjëson mësuesin e gjuhës së huaj për një ndërveprim me mësues të lëndëve të tjera dhe për domosdoshmërinë e një lidhjeje ndërkurrikulare.

Lëndët me të cilat mund të ndërveprojë gjuha e huaj, janë:

Historia, e cila, me ngjarje dhe fakte të mëdha, mund të ndihmojë në formimin kulturor e intelektual të nxënës/it,-es për njohjen e vlerave historike-shoqërore të popujve gjermanishtfolës, të personaliteteve të shquara etj.

Gjeografia, e cila, me njohuritë e saj, mund të japë informacion, p.sh., për vendet turistike në Gjermani, Austri dhe Zvicër, duke lehtësuar kuptimin e temave mbi turizmin, zakonet turistike, kulturën e pushimeve apo të kohës së lirë, në këto vende; për parapëlqimet, shijet që lidhen me to etj.

Filozofia, e cila mund të ndriçojë çështje të formimit intelektual e shpirtëror të popujve gjuha e të cilëve mësohet, mënyrën e tyre të menduarit, kredot e mëdha, bindjet e atij populli etj.

Sociologjia, e cila mund të lehtësojë kuptimin e dokeve, zakoneve, vlerave shoqërore të një populli të huaj që kondicionohen nga një kontekst shoqëror dhe nga një realitet i ndryshëm nga i yni. Vetë njohja e gjuhës së huaj dhe e një kulture të huaj kultivon te nxënës/i,-ja ndjenja të tolerancës, pranimit të shumëllojshmërisë etj., që lidhen ngushtë me zbatimin e të drejtave të njeriut dhe me edukimin qytetar.

Ky ndërveprim, sigurisht, nuk është dhënë në mënyrë shteruese. Mësues/it,-et ndërgjegjësohen dora-dorës për këtë proces ndërveprimi midis lëndëve sipas tematikave dhe përmbajtjes së mësimin.

Programi i klasës 12-të parashtron objektiva që, sipas standardeve, nxënës/i,-ja të arrijë në të katër aftësitë, përforcimin e nivelit B1 dhe arrijen deri në nivelin B1+, duke iu referuar si gjithmonë *Kuadrit të Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët*.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është dokument zyrtar i detyrueshëm për t'u zbatuar nga përdoruesit e tij (mësues, autorë të teksteve etj.). Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Programi lëndor është vetëm një pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare, të cilat janë të detyrueshme.

A) Objektivat

Një objektivi përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm.

Mësues/i,-ja dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënës/it,-et dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çfarë përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Programi i klasës 12-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies/mësimnxënies së gjuhës.

B) Orët mësimore

Duhet të theksojmë se programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të është strukturuar sipas një formati të ri, i cili mbështetet në standardet e fushës dhe në objektivat për secilin standard. Gjithashtu, programi jep dhe objektiva për çdo aftësi. Objektivat përcaktojnë atë që nxënës/i,-ja do të arrijë në përfundim të vitit shkollor për këtë lëndë.

Shpërndarja e orëve mësimore

Lënda e gjuhës gjermane në klasën e 12-të të shkollës së mesme të gjuhëve të huaja zhvillohet me 4 orë mësimore në javë:

$$34 \text{ javë} \times 4 \text{ orë} = 136 \text{ orë vjetore.}$$

Shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 104 orë, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 90 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (70% e tyre, që përbëjnë 63 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 27 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive. Me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përf forcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni). Aktet dhe funksionet e komunikimit do të zënë 14 orë (70% e tyre, që përbëjnë 10 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 4 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës. Ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

Formimi gjuhësor zë 32 orë. Janë kryesisht orë, në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (70% e tyre, që përbëjnë 23 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 9 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përf forcimin). Përmbajtja mësimore e lëndës së gjuhës gjermane për klasën e 12-të të shkollave të mesme të gjuhëve të huaja realizohet duke synuar nivelin B1+.

Këtu duhet mbajtur parasysh, sigurisht, edhe përdorimi i gjuhës nga nxënës/i,-ja, pra përvetësimi i aftësisë pragmatike, që do t'i lejojë atij/asaj ta përdorë gjuhën sipas qëllimeve të caktuara. Formimi gjuhësor, gjithashtu, duhet të privilegjojë aftësitë komunikative të gjuhës larg formave të mësimin tradicional të gramatikës.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përfshin:

- Përsëritjen e njohurive bazë të tij (konceptet themelore).
- Testimin e njohurive bazë.
- Integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e marra.

- Integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme.).
- Përsëritjen vjetore.
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë përpunimit të njohurive, duhet t'u kushtohet kohë e posaçme:

- Kultivimit të aftësive të përgjithshme, si të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore, të të menduarit kritik dhe krijues.
- Kultivimit të aftësive të posaçme lëndore, si: komunikimi gojor, shkrimi riprodhues e krijues, kuptimi i teksteve me vështirësi dhe gjatësi mesatare, kalimi nga kuptimi thelbësor tek ai më i detajuar, kuptimi me gojë dhe ndërveprimi bisedor etj.
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe ai gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Programi i klasës së 12-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies/mësimnxënies së gjuhës gjermane në nivelin B1+.

Mësuesi është i lirë të përdorë larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/mësimnxënies për t'ua përshtatur nevojave të nxënës/it,-es në klasa të ndryshme. Ai i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënës/it,-es në vijueshmëri të këtij procesi.

Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës. Ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara.

Metoda dhe strategji të mësimdhënies/mësimnxënies

Në tabelën më poshtë përshkruhen disa strategji dhe mënyra didaktike sipas aftësive gjuhësore: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit.

Të dëgjuarit

- Të mbajë shënime gjatë dëgjimit;
- të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor;
- të përqendrohet në kërkesat e dëgjimit;
- të dëgjojë një tekst të shkurtër dhe të kuptojë frazat e thjeshta apo fjalë të caktuara.

Të folurit

- t'i kërkojë folësit të përsërisë çfarë tha, në rast moskuptimi;

- të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose një shprehje, por të përdorë fjalë e shprehje të njohura;
- t'i kërkojë folësit të përsërisë më ngadalë atë që tha, në rast moskuptimi;
- të përdorë fjalë me komplekse për të shprehur diçka,
- të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.

Të shkruarit

- Të mbajë shënime për informacionin që i duhet të përfshijë në detyrën e caktuar;
- të planifikojë paragrafët, duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf;
- të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse.

Të lexuarit

- Të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimi, dy rreshtat e parë të mësimi;
- të lexojë tekstin për herë të dytë, që të nxjerrë kuptimin e fjalëve të panjohura;
- të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme;
- të gjejë në tekst përgjigjet e pyetjeve, duke përcaktuar paragrafin që u përket pyetjeve;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor;
- të përdorë përshkrimin me fjalë të njohura, kur nuk di kuptimin e një fjale të dhënë.

C. Parime për zbatimin e programit

Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të procesit mësimor

Nxënësi duhet të jetë në qendër të procesit mësimor dhe të gëzojë të drejta të plota pjesëmarrjeje, duke shprehur përvojën e tij jetësore. Kjo do të realizohet:

- Duke përzgjedhur tema, lloje të teksteve dhe forma sociale të orientuara sipas interesave dhe nevojave të moshës së klasës së 12-të, duke pasur parasysh nivelin dhe rezultatet e nxënësve.
- Duke përdorur strategji që e nxisin nxënës/in,-en të veprojnë me gjuhën.

Krijimi i mjedisit të të nxënit

Mësues/it,-et tanë/tona duhet të ndërjegjësohen se është shumë e domosdoshme që nxënës/i,-ja të ndihet i/e sigurt. Kjo arrihet nëpërmjet krijimit të një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor, i cili mundëson një mësimdhënie/mësimnxënie që plotëson ndjeshëm nevojat dhe objektivat e përcaktuar më parë.

Organizimi i klasës

Vendosja e nxënësit në qendër të procesit mësimor do të sjellë ndryshimin e rolit tradicional të mësuesit. Mësuesi do të jetë organizues, furnizues dhe orientues për nxënësit. Ai do t'i ndihmojë nxënësit për një të mësuar të qëndrueshëm. Mësuesi ka më tepër rol planifikues, sesa burim i të gjitha njohurive në klasë.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe atë të situatave sa më afër jetës reale etj.

Mësuesi është i lirë dhe i pavarur në përdorimin e metodave dhe të materialeve mësimore që mbështetin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore si të nxënësve, ashtu dhe të mësuesve.

Organizimi i mësimit mundëson punën në grupe dhe nxit lirshmërinë e nxënësve. Atmosfera e klasës është mbështetje dhe respekt për përgjigjen e nxënës/it,-es si nga mësues/i,-ja, ashtu edhe nga nxënësit e tjerë. Nxënës/i,-ja ndërkohë mëson edhe nga shokët dhe shoqet e tij/saj. Edhe në nivelin B1+ duhet të synohet që nxënësi/i,-ja të punojë në mënyrë të pavarur, duke menduar vetë për zgjidhjen e një problemi.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësimi i gjermanishtes i drejton nxënësit drejt pavarësisë në rritje në përfitimin gjuhësor, e mundësuar kjo nëpërmjet aktiviteteve përkatëse të të mësuarit, formave të larmishme sociale. Duhet të theksojmë rolin e veçantë që duhet të zënë puna me grupe, me partner. Puna në grupe ndihmon, gjithashtu, në shoqërizimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrin dhe me mësues/it,-et nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

Përdorimi i gjuhës në klasë

Në nivelin gjuhësor B1+, nxënës/i,-ja është më i formuar nga ana gjuhësore e kulturore dhe është i gatshëm të përdorë gjuhën gjermane në situata reale, si p.sh., në kryerjen e veprimtarive gjuhësore, në dhënien e udhëzimeve për punët e përbashkëta në projekte ku ka ndarje dhe përgjegjësi ndaj detyrave të caktuara.

Të mësuarit e gramatikës

Njohuritë gramatikore përbëjnë një objektiv të rëndësishëm të mësimit të gjuhës gjermane. Strukturat gramatikore nuk duhet të jepen të izoluara, si qëllim në vetvete, por në lidhje me aftësitë gjuhësore dhe me përpunimin e temave dhe të kompetencave leksikore. Gramatika duhet të konceptohet përgjithësisht në mënyrë deduktive, me qëllim që të nxiten nxënësit drejt një procesi analitik dhe nga mendimi kritik. Duhet të hiqet dorë nga dhënia paraprake nga mësuesit e rregullave dhe tabelave shabllone. Futja e strukturave të reja gramatikore duhet të bëhet nga vetë nxënës/it,-et nëpërmjet dhënies së shembujve të shumtë dhe të larmishëm.

Korrigjimi i gabimeve

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të pasqyron më së miri mënyrën më të plotë të korrigjimit të gabimeve nga vetë nxënësi. Niveli B1+ parashikon një shkallë më të lartë të saktësisë gjuhësore për të siguruar një komunikim të qartë.

Puna e diferencuar me nxënësit

Me qëllim që metodat e mësimdhënies/mësimnxënies, parimet dhe strategjitë mbi të cilat realizohen këto metoda të kenë arritje sipas standardeve të përcaktuara, mësuesi planifikon punën e diferencuar me nxënësit.

Duke pasur parasysh përbërjen heterogjene të klasave tona, mësuesi duhet të parapëlqejë punën në grupe, kështu ai mund të krijojë grupe mikse me nxënës/e të përparuar/a dhe të prapambetur/a; duke caktuar detyra në grup, për të mos i vënë në vështirësi dhe për t'i inkurajuar të zgjidhin ato detyra që mundën. Mësues/i,-ja mund t'u japë gradualisht detyra plus për të siguruar një nivelim të tyre me të tjerët, por duke bërë kujdes dhe duke gjetur detyra motivuese e tërheqëse që të mos rrisë vështirësitë.

Një motivim i mirë për thellimin e njohurive të gjermanishtes, konkretisht për nxënësit e përparuar, është puna e veprimtarive shtesë, si përzgjedhje e materialeve autentike, krijime me shkrim në kuadër konkurses, recitime ose vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj etj. Mësuesi mund të përdorë punën e këtyre nxënësve për të realizuar bashkë me ta një aspekt shumë të rëndësishëm të metodologjisë së zbatimit të programit, si integrimi lëndor, ku nxënësit e përparuar mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

Mësues/i,-ja mund të përdorë teknikat e mëposhtme për tërheqjen e të gjithë nxënësve në mësim:

- Të ndjekë klasën në çdo hap, brenda dhe jashtë saj;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej nxënësve vlerësime të punës së tij, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive;
- të shmangë çdo gjë që nuk i përshtatet moshës së nxënësve;
- të zgjedhë materiale për mësim në përputhje me kërkesat dhe standardet e programit mësimor;
- të përpiqet ta mënjanojë diçka, nëse nuk ecën në klasë, dhe të përdorë punën në grup ose për individë të veçantë, punën individuale;
- të përdorë ushtrime që kërkojnë pjesëmarrje aktive, duke nxitur edhe nxënësit me dije jo të plota të përfshihen në to;
- të shmangë ushtrime që i vënë këta nxënës në vështirësi dhe i zënë ngushtë;
- të motivojë nxënësin edhe për një detyrë fare të vogël që ka bërë, me qëllim që të rritet dëshira dhe përgjegjësia për mësimin e gjuhës së huaj;
- të mos paragjykojë nxënësit, por përkundrazi, t'u japë ushtrime që kërkojnë vëmendje dhe punë.

7. VLERËSIMI

Vlerësimi i përparimit të nxënësit do të realizojë matjen e përparimit dhe të arritjeve të nxënësve në gjuhën e huaj. Të vlerësosh nxënësin është jo e lehtë dhe kjo mund të bëhet në mënyra nga më të ndryshmet.

Vlerësim diagnostikues

Ky vlerësim do të realizohet përmes njohjes dhe vlerësimit të arritjeve dhe të mangësive, duke i dëgjuar nxënësit të flasin dhe të lexojnë, duke vëzhguar të shkruarit e tyre dhe duke analizuar llojet e produkteve të tyre në procesin mësimor:

- Ky lloj vlerësimi jep informacion për efektshmërinë e të nxënësve;
- ndihmon në gjetjen e mënyrës së veprimit në etapën e dytë të të mësuarit;
- ndihmon në gjetjen e arsyeve të mospërvetësimit të koncepteve.

Vlerësim formues

Nëpërmjet këtij vlerësimi synohet të theksohet ajo çfarë ka arritur nxënësi gjatë procesit të formimit të njohurive. Ky vlerësim kryhet në fillim: për vendosjen e objektivave në procesin mësimor, gjatë vitit: për të vlerësuar ecurinë e njohurive të fituara, për përmirësim, si dhe në fund të vitit: për të parë se çfarë është arritur.

Vlerësim përmbledhës

Ky vlerësim bëhet në fund të një numri temash, njësisish, detyrash e kapitujsh, ose në fund të një periudhe të caktuar kohore.

Vlerësim motivues ka për qëllim të nxisë interesin dhe dëshirën e nxënësve për të mësuar.

Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitës sesa suksesi i arritur, duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës/e.

Do të inkurajohen nxënësit të njohin procedurat e vlerësimit si mundësi për *vetëvlerësim*. Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës gjermane, ku secili jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësues/i,-ja.

Vetëvlerësimi ka efekt kur ai u referohet normave dhe kapacitetit që korniza e gjuhëve parashtron për grupmoshën dhe kur ky vlerësim është i lidhur me një përvojë të veçantë, që mund të jetë ajo e kalimit të testeve. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin në vazhdimësi.

Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli European i Gjuhëve (PEGj) që, me anë të tri pjesëve të tij (Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë Gjuhësore dhe Dosjes), nxit nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe duke dokumentuar arritjet e tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.

Portofoli European i Gjuhëve është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGj-i e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste, dhe të vazhdojë t'i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGj-i e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGj-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Europë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas, mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentin përfundimtar.
- Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit/-es.
- Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij, duke përdorur edhe gjuhën amtare.
- Mësues/i,-ja bisedon me nxënës/in,-en individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin, që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi. Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxëniet e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi.

Nxënësit do të nxitin të zhvillojnë të menduarit e pavarur dhe vetëdijen për aftësinë e tyre për përmirësime përmes kuptimit të hollësishëm të procedurave të vlerësimit. Nëpërmjet vetëvlerësimit, nxënësit vlerësojnë veten nëpërmjet një pyetësi mbi atë se "*çfarë di të bëjë?*".

Vetëvlerësimi është një formë e re, por tashmë mjaft e përhapur në botën arsimore. Ai është pjesë e të mësuarit të pavarur dhe konsiderohet mjaft i nevojshëm jo vetëm nga nxënësit, por edhe nga mësuesit. Është detyrë e çdo mësuesi të shpjegojë e të njohë nxënësit me përmbajtjen e vetëvlerësimit, përdorimi i të cilës do të sjellë ndërgjegjësim të mëtejshëm të problemeve të të mësuarit.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve dhe as vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara nga orët e kaluara dhe rreth mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here, mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve, që në fillim, qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim

Ky lloj vlerësimi shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësues/i,-ja vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të realizuara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disaminutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënit, deri tek ato njëorëshe; teste me alternativa ose me zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar. Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi është në rolin e atij që drejton, që rekomandon, që orienton.